



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351- 183644

Dt. 25.10.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e së Albert Gjonaj nga Prizreni me banim në rrugën "Bujtina"nr/ bazë të neneve 3-1.7 , 1.17. dhe të nenit 14.1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit- Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. e në lidhje me nenin 84. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: së Albert Gjonaj nga Prizreni ndërtimi i objektit - lokal afarist-banesor në Prizren në vendin e ashtuquajtur Qendër Historike rrugën "Bujtina"nr/ 1/46,48 në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. 04-353-1282 si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e NPNT,„Diarko”, Prizren4

II. Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit veçantë.

III. Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej 76.051,57 €.

IV. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s'është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga parallogaria e vlerës së objektit.

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.

VI. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.

VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.

VIII. Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës

IX. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).

X. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK,KEDS-it, dhe avari tjera ti evitohet dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi

... /...

.../...

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës: së **Albert Gjonaj** nga **Prizreni** me banim në rrugën **"Bujtina"nr/** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - lokal afarist- banesor.**

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s'bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, pëlqimet e kërkuara të parashtruara , Aktvendimin mbi lokacionin, si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtim e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.


Nga se u tha më lartë u muarr aktvendimi si në dispozitiv.


KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Hartuan:

Bashkëpunëtorët profesional:


Refki Masbegu, inxh.dipl.nd.



DREJTORI:


Visar Islamaj